REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA SHTIME/ OPSTINA-STIMLJE/ MUNICIPALITY OF SHTIME
ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PREDSEDNIKA/MAYOR'S OFFICE

Nr. i Protokollit: 02/568

# Procesverbal nga dëgjimi publik me banorët e fshatit Reçak

E marte, më 20 qershor 2023
Kohëzgjatja e takimit: 16:30 –17:20
Vendi i takimit: SHMFU ''Skënderbeu''

Pjesëmarrës në takim ishin: Kryesuesi i Kuvendit - Adnan Ademi; Drejtori i Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi - Grejtalb Emini dhe Drejtori i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik - Kastriot Shabani.

Rendi i ditës:

1. **Korniza Afatmesme Buxhetore 2024-2026**

Këtë takim e hapi Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Shtimes, Adnan Ademi, i cili i ka përshëndetur të pranishmit dhe i ka falënderuar për bashkëpunimin e treguar dhe njëherit ka sqaruar rëndësinë e këtij takimi.

Më tutje z. Ademi sqaroi Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitin 2024-2026 dhe në detaje dha informata rreth investimeve të cilat janë bërë dhe të cilat priten të përfundojnë brenda këti viti. Ai kërkoi nga banorët që problemet e tyre të cilat i kanë si fshat, t'i drejtojnë sot nga ne që më pas ato kërkesa të vendosen në buxhetin e vitit të ardhshëm, por sigurisht ato kërkesa të cilat janë primare të marrin një peshë më të madhe dhe të vihen në fillim të listës.

Kërkesat e banorëve të fshatit Reçak:

- **Adem Ramadani:** Nga rruga ''Ëilliam Ëalker'', të rregullohet trotuari që lidhet me rrugën ''Qorr Ilazi''. Kërkesa e radhës është për ujë të pijshëm, sa i përket ujësjellësit është e nevojshme të rivitalizohet vrella e Reçakut (ku së pari duhet të bëhet një analizë e ujit a mund të përdoret dhe sa banorë mund të furnizohen me atë ujë).
  Të rregullohet rruga ''Ëilliam Ëalker'', nga ura e Reçakut e që më pas vazhdon nga Shtimja, pasi që ka shumë dëmtime.
  Në rrugën ''Ahmet Kaqiku'', tek pjesa e trotuarit, të bëhet një muri mbrojtës rreth trotuarit dhe ndriqimi.
- **Minush Brahimi:** Të rregullohet ndriqimi në rrugën ''24 Marsi''.

- **Skender Bajrami:** Kanalizimi dhe ujësjellësi të rregullohen dhe të jenë primare në fshatin Reçak.
- **Arsim Rama:** Një parking para shkollës së Reçakut. Në rrugën ''2 Korriku'', rivitalizimi i rrugës dhe vazhdimi i një segmenti në po të njëjtën rrugë.

Procesmbajtës,
Gentiana Mehmeti

**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/**
**REPUBLIC OF KOSOVO**
**KOMUNA SHTIME/ OPSTINA-STIMLJE/ MUNICIPALITY OF SHTIME**

**Lista e pjesëmarrësve** Regak

**Data:** 20.06.2023

| Nr | Emri dhe Mbiemri | Nënshkrimi |
|---|---|---|
| 1 | ADEM RAMADANI | |
| 2 | ARMEND IMERI | |
| 3 | Skender Bajrami | |
| 4 | Minush Brahimi | |
| 5 | AFSIM RAMA | |
| 6 | Besnik Seferi | |
| 7 | | |
| 8 | | |
| 9 | | |
| 10 | | |
| 11 | | |
| 12 | | |
| 13 | | |
| 14 | | |
| 15 | | |
| 16 | | |